



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:138852

Datë: 27.06.2024

Numri i dokumentit: 05870803

KE.nr.1038/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike të paditësve 1. The Coca Cola Company, me seli në SHBA dhe 2. European Refreshments, me seli në Southgate Dublin Road Drogheda, të cilët i përfaqëson Xhevdet R. Rama, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit “Dea IB” SH.P.K., me seli në Gjakovë, me NRB: 811298274, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Liman Musa, avokat nga Ferizaj, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prezencë të përfaqësuesit të palëve paditëse dhe përfaqësuesit të palës së paditur, me datën 13.06.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve I. The Coca Cola Company dhe II. European Refreshments dhe VËRTETOHET se i padituri “Dea IB” SH.P.K., përmes importimit të 66.000 copave të kanaqes (0.33L) të pijes së gazuar joalkoolike me shenjën “Coca-Cola”, me datën 05.10.2020, ka shkelur markën tregtare të regjistruar të paditësit të parë “Coca – Cola, si dhe përmes importimit të 66.000 copave të kanaqes (0.33L) të pijes së gazuar joalkoolike me shenjën “SCHWEPPEES BITER - LEMON”, me datën 16.10.2020, ka shkelur markën tregtare të regjistruar të paditësit të dytë “SCHWEPPEES”.
- II. DETYROHET i padituri që paditësve të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,340.60 € (një mijë e treqind e katërdhjetë euro e gjashtëdhjetë cent)), në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit The Coca Cola Company dhe European Refreshments, përmes të autorizuarit të tyre, me datën 20.10.2020, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, kanë paraqitur padi për shkeljen e markës tregtare kundër të paditurit “Dea IB” SH.P.K., duke kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve dhe të vërtetohet se i padituri “Dea IB” SH.P.K., me përdorimin e markës tregtare figurative dhe verbale të paditësve “COCA-COLA” dhe “SCHWEPPEES”, gjatë importimit të 66.000 copë kanaqe 0.33L pije freskuese “SCHWEPPEES BITTER LEMON” dhe 66.000 copë kanaqe 0.33L të pijes freskuese “COCA – COLA”, ka shkelur markat tregtare figurative të paditësve të regjistruara në territorin e Republikës së Kosovës, sipas numrave 021081, 002982 dhe 000157, si dhe të urdhërohet Dogana e Kosovës – Sektori për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale që të asgjësoj mallin e ndaluar sipas rasteve doganore nr. 145/2020 dhe 154/2020 me shpenzimet e të paditurit, si dhe të obligohet i padituri që të i kompensoj shpenzimet procedurale të paditësit.

Në referatin e padisë ka theksuar që me datën 05.10.2020 paditësi i parë, ndërsa me datën 16.10.2020 paditësi i dytë, janë njoftuar nga Dogana e Kosovës, se është pezulluar lirimi i mallrave kontestuese të paditurit, për shkak të dyshimit se të njëjtat shkelin markat tregtare të paditësit duke theksuar që paditësit i kanë të mbrojtura markat tregtare të regjistruara sipas numrave 021081, 002982 dhe 000157.

I autorizuari i paditësve, gjatë seancave gjyqësore ka hequr dorë nga kërkesa që të urdhërohet Dogana e Kosovës që të mbaj në ndalim dhe të asgjësoi mallrat kontestuese, ndërsa ka mbetur pranë kërkesëpadisë sa i përket kërkesës që të vërtetohet shkelja e markave tregtare nga ana e të paditurit, duke shtuar që i padituri nuk ka pasur autorizim që këto mallra ti distribuoj në territorin e Republikës së Kosovës, meqenëse paditësit janë bartës të së drejtës dhe e kanë të drejtën ekskluzive që shenjat e mbrojtura si markë tregtare të ia ndalojnë, personave të tjerë që ta shfrytëzojnë atë pa autorizim.

Paditësit, kanë deklaruar se nuk qëndron pretendimi i të paditurit se në rastin konkret është bërë shterimi i të drejtave të fituara nga një markë tregtare, pasi që çështja e cila është objekt shqyrtimi, i përket periudhës kohore në të cilën ka qenë në fuqi, ligji i vjetër për Markat Tregtare, i cili nuk ka paraparë shterimin e të drejtave të fituara siç përcaktohet me Ligjin ri për Markat Tregtare.

Në fjalën përfundimtare ka deklaruar që nga provat e bashkëngjitura padyshim se është vërtetuar që i padituri me importimin e sasisë prej 66.000 të kanaqeve për pijen freskuese Coca Cola sipas rastit doganor 145-2020 të datës 05.10.2020 dhe importimin e 66.000 kanaqeve të pijes freskuese Schweppes, sipas rastit doganor 154-2020 të datës 16.10.2020 ka shkelur markat tregtare të paditësve, pasi që importimi i këtyre mallrave është bërë pa autorizimin e paditësve dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 8 të LMT-së, së vjetër e cila ka qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhur rasti. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

I padituri në përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se kemi të bëjmë me mall origjinal të prodhuar nga një degë apo nën përfaqësi e autorizuar, në rastin konkret konform rregullave dhe rekomandimeve të BE-së, të cilat Kosova është e obliguar t'i zbatoj. Ka shtuar se në rastin konkret kemi pasur të bëjmë me import paralel, dhe për këtë arsyeje pasi që malli ka qenë origjinal është liruar për të vazhduar në tregun e lirë të shitjes, pasi që në të kundërtën, në rast të ekzistimit të shkeljeve të markave tregtare, malli nuk do të lejohej të dilte në qarkullim të lirë, duke konsideruar se në bazë të rregullave ligjore, malli për tu ndaluar duhet të jete medoemos i falsifikuar, kurse në rastin konkret ka theksuar që kemi të bëjmë me mall origjinal të prodhuar nga një degë apo përfaqësi e autorizuar, nga mbajtësi i markës tregtare, për tu plasuar këto mallra në treg.

Me tutje ka shtuar se edhe me sqarimin e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, është sqaruar se këto mallra do të konsiderohen si mallra origjinale dhe do të plasohen në treg, pasi që janë të prodhuara nga një degë apo përfaqësi e autorizuar nga prodhuesi, duke theksuar se edhe me LMT e re, është e paraparë dhe sqaruar se këto mallra janë origjinale dhe të njëjtave i lejohet plasimi në treg.

I ka propozuar gjykatës që të refuzohet padia e paditësit si e pabazuar, ndërsa shpenzimet e procedurës i ka kërkuar konform TOAK-së.

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Vendimi për regjistrimin e markës tregtare në regjistrin e markave tregtare me numër 21081 numër aplikimi KS/M/2016/681, të datës 18.05.2016; Vendimi për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me numër nr. regj.2982,

nr.apl.925/2008; Lista e distribuimit – kërkesa për verifikimin e origjinalitetit për markën tregtare – rasti 145-2020 “Coca Cola”, i datës 05.10.2020, se bashku me aneksin IV; Foto dokumentacioni në përbërje prej 3 fotografive; Lista e distribuimit – kërkesa për verifikimin e origjinalitetit për markën tregtare – rasti 154-2020 SCHWEPPEES, i datës 16.10.2020, se bashku me aneksin IV; Vendimi për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me numër nr. regj.157, nr.apl.895/A/2008; Foto dokumentacioni në përbërje prej 3 fotografive; Lista e distributoreve nga bartësi i të drejtës së markës tregtare për Kosovë; Komunikimi me email i datës 19.10.2020 dhe 21.10.2020; Deklarata e lëshuar nga The Coca Cola Company, me seli në Atlanta, e datës 05.10.2020, në gjuhën angleze dhe e përkthyer në gjuhën shqipe; Deklarata nga European Refreshments, e datës 23.10.2020, në gjuhën angleze dhe e përkthyer në gjuhën shqipe.

Deklarimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas vendimit për regjistrimin e markës tregtare në regjistrin e markave tregtare me nr. 21081 numër aplikimi KS/M/2016/681, të datës 18.05.2016 dhe vendimit për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me nr. regj.2982, nr.apl.925/2008, vërtetohet se paditësi i parë, ka regjistruar dhe e ka vazhduar regjistrimin, pranë Agjencisë së Pronësisë Industriale dhe është pronar i markës tregtare me emrin “COCA – COLA” dhe është bartës i të drejtës së markës tregtare për produktet dhe shërbimet nga Klasa 30 dhe 32 e Klasifikimit të Nicës.

Sipas Listës së Distribuimit – Njoftim nga Dogana e Kosovës, - Rasti 145-2020 “Coca Cola”, të datës 05.10.2020, se bashku me aneksin IV, vërtetohet se mallrat kontestuese të paditurit, në sasi prej 66.000 copë, kanaqe 0.33 litra, të pijes freskuese “Coca – Cola”, janë ndaluar nga Dogana nën dyshimin për shkelje të së drejtës së markave tregtare të paditësit, ndërsa nga fotot e prezantuara të cilat gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet se mallrat kontestuese të paditurit përmbajnë shenjë identike me markat tregtare të regjistruara të paditësit.

Sipas Listës së distribuimit – Njoftim nga Dogana e Kosovës, rasti 154-2020 “SCHWEPPEES”, të datës 16.10.2020, se bashku me aneksin IV, vërtetohet se mallrat kontestuese të paditurit, në sasi prej 66.000 copë, kanaqe 0.33 litra, të pijes freskuese “Schweppes Biter -

Lemon”, janë ndaluar nga Dogana nën dyshimin për shkelje të së drejtës së markave tregtare të paditësit, ndërsa nga fotot e prezantuara të cilat gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet se mallrat kontestuese të paditurit përmbajnë shenjë identike me markat tregtare të regjistruara të paditësit.

Sipas vendimit për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare në regjistrin e markave tregtare me numër të regjistrimit 157 dhe numër të aplikimit 895/A/2008, vërtetohet se paditësi i dytë, ka regjistruar dhe e ka vazhduar regjistrimin, pranë Agjencisë së Pronësisë Industriale dhe është pronar i markës tregtare verbale me emrin “SCHWEPPES”, dhe është bartës i të drejtës së markës tregtare për produktet dhe shërbimet nga Klasa 32 dhe 33 e Klasifikimit të Nicës.

Nga deklarata e lëshuar nga The Coca - Cola Company, me seli në Atlanta, të datës 05.10.2020, si dhe nga Deklarata e lëshuar nga European Refreshments me datën 23.10.2020, është konstatuar se produktet e sekuestruara nga Dogana e Kosovës, për rastin 145-2020 “Coca Cola” dhe rastin 154-2020 “SCHWEPPES” (në sasi prej 66.000 copë kanaqe 0.33L pije freskuese “SCHWEPPES BITTER LEMON” dhe 66.000 copë kanaqe 0.33L pije freskuese “COCA – COLA”) shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale të paditësve The Coca Cola Company dhe European Refreshments.

Gjykata pas shqyrtimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, sepse shenja që është përdorur në produktet e të paditurit është identike me markat tregtare të paditësve dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e të paditurit nuk ka asnjë dyshim se mund të shkaktojnë konfuzion në publik dhe secili konsumator do të krijoj bindjen se bëhet fjalë për produktet e paditësit.

Sipas Nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-026 Për Markat Tregtare (LMT) i aplikueshëm në rastin konkret, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund t'i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjë identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Bartësi i markës së regjistruar tregtare gëzon një numër të drejtash me regjistrimin e markës tregtare. Sipas LMT, bartësi i markës së regjistruar tregtare ka drejta të: ndalojë

përdorimin e paautorizuar të markës tregtare të tij përmes mjeteve juridike në dispozicion (Nenet 8 – 13 i LMT); të përdorë markën e regjistruar në tregun e Kosovës (Neni 14 i LMT), si dhe të disponojë me markën tregtare të tij (Nenet 15 – 22 i LMT).

Mbajtësi i një marke tregtare sipas Nenit 8 të LMT-së, ka të drejtë të ndalojë: vendosjen e markës së mbrojtur, në mallra, në paketim ose etiketat e mallit; ofrimin e mallrave, vendosjen e tij në treg apo ruajtjen e saj për këto qëllime, apo ofrimin e shërbimeve nën markën tregtare të tij; importimin, eksportimin ose transitin e mallrave nën markën tregtare dhe përdorimin e markës së mbrojtur në dokumentet zyrtare ose për reklama.

Përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare, si e drejtë ekskluzive e pronarit të saj, përbën shkelje të markës tregtare. Sipas Nenit 8 të LMT-së, shkelja mund të bëhet me çdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me të cilin atakohet të paktën njërën prej të drejtave të pronarit të markës tregtare. Kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar.

Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës rezulton si jokontestues fakti se i padituri ka importuar mallrat kontestuese pa autorizimin e paditësve, si bartës të së drejtave nga markat tregtare të regjistruara “COCA - COLA” dhe “SCHWEPPEES”. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, fakti se mallrat janë origjinale ose jo, nuk përbën fakt relevant për vlerësimin e shkeljes së markës tregtare. Bazuar në dispozitat e sipërcituara vetëm fakti i importimit dhe vendosjes në treg të mallrave në tregun përkatës, pa autorizimin e bartësve të së drejtës së markave tregtare të regjistruara, përbën shkelje të markës tregtare.

Gjykata e vlerëson si të pabazuar pretendimin e të paditurit se në rastin konkret importimi i mallrave kontestuese nuk përbën shkelje të markave tregtare të paditësve, meqenëse të njëjtat janë origjinale dhe se shitja e tyre është e lejuar sipas importit paralel, për arsyt në vijim:

Ezaurimin (humbja) e të drejtave të markës tregtare (exhaustion of rights principle) – Doktrina apo parimi i “shterjes së të drejtave” pas “shitjes së parë” përbën parim sipas të cilit kontrolli i bartësit të markës tregtare mbi produktin apo shërbimin që bartë markën e tij tregtare pushon pas shitjes së parë të produktit. Ky parim i referohet kontrollit mbi produktin dhe jo kontrollin mbi markën tregtare si pronë e paprekshme. Kjo ndërlidhet me faktin se, një ndër të drejtat kryesore të bartësit të një marke tregtare është përdorimi i asaj marke në produktet e

caktuara dhe që, ndër të tjera, nënkupton edhe hedhjen e produktit që mban atë markë në tregun e caktuar. Pra, hedhja e produktit në një treg të caktuar mund të bëhet vetëm nga bartësi i markës apo me pëlqimin e tij.

Shtete të ndryshme aplikojnë rregulla të ndryshme sa i përket parimit të “shterjes së të drejtave”. Disa shtete kanë aplikuar parimin e ezaurimit ndërkombëtar, që nënkupton se kontrolli i bartësit të markës tregtare mbi produktin pushon kur ky produkt të vendoset në tregun e cilitdo shtet në botë. Disa shtete aplikojnë parimin e ezaurimit regjional, ndërsa një numër i tyre aplikojnë parimin e ezaurimit nacional. Si rrjedhojë e kësaj mos harmonie midis shteteve të ndryshme, Marrëveshja TRIPS nuk ka adoptuar një politikë apo rregull sa i përket ezaurimit. Sipas nenit 6 të TRIPS, secili shtet anëtar është i lirë që të adoptojë ezaurimin ndërkombëtar, regjional ose nacional përderisa nuk janë në kundërshtim me dy parimet tjera të TRIPS, përkatësisht parimin e trajtimit kombëtar dhe parimin e trajtimit më të favorshëm. Direktiva e BE-së [Direktiva e Parë e Këshillit 89/104/EEC (1988)] –, shumë qartë e përcakton parimin e ezaurimit regjional. Kjo nënkupton se bartësi i markës tregtare humb të drejtën të kontrolloj qarkullimin e produktit i cili e bartë markën e tij tregtare në momentin e vendosjes së këtij produkti në tregun e cilitdo shtet të Bashkimit Evropian.

Megjithatë, sikurse edhe shumica e shteteve të Bashkimit Evropian, LMT i Kosovës aplikon parimin e ezaurimit nacional derisa Republika e Kosovës të anëtarësohet në Bashkimin Evropian (neni 12, paragrafi 1 i LMT të aplikueshëm në rastin konkret). Pra, sipas kësaj të drejtat e bartësit të markës së regjistruar për të kontrolluar qarkullimin e mallrave apo shërbimeve do të pushojë vetëm kur këto mallra apo shërbime janë futur në tregun e Kosovës nga pronari apo me pëlqimin e tij. Për pasojë, në rast të importit paralel apo vendosjes së produkteve të caktuara (autentike) në tregun e Kosovës, pa lejen e bartësit, i njëjti mund të kërkojë nga gjykata të ndalojë një veprim të tillë meqë ky veprim paraqet shkelje të markës tregtare të mbrojtur.

Neni 12 i LMT-së, përcakton qartë se: *“humbja e të drejtës për ndalimin e përdorimit të markës për produkte dhe shërbime fillon me futjen e markës në tregun e Republikës së Kosovës nga ana e vet pronarit ose pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, në ndonjërin nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian apo shteteve që janë palë në Marrëveshjen që krijon Zonën Ekonomike Evropiane, me atë markë tregtare”* çka nënkupton se shterja e së drejtës sipas shitjes së parë bëhet vetëm në rastet kur bartësi i të drejtës së markës tregtare e shet vet atë produkt apo përmes të autorizuarit të tij, në territorin e Republikës së

Kosovës, por kjo e drejtë nuk konsumohet nëse produkti është shitur jashtë Republikës së Kosovës, si në rastin konkret.

Duke u nisur nga të lart cekurat, Gjykata ka gjetur se i padituri me importimin e mallrave kontestuese dhe vënien e tyre në treg, pa autorizimin e bartësit të markës tregtare të regjistruar, ka shkelur markat tregtare të paditësve.

Gjykata vlerësoi edhe provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk kishin ndikim për vendosjen ndryshe në këtë çështje kontestimore

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjyqimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi me zbatimin e rritjes prej 100% për shkak të kontestit me element të huaj sipas tarifës së OAK dhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej 208 €, për taksën gjyqësore shumë prej 51.00 €, si dhe përfaqësim në katër seanca gjyqësore shumë prej 1081.60 €, (270.40 € x 4), në shumë të përgjithshme prej 1,340.60 €.

Nga arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.1038/22, datë 13.06.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjyqimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.